

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6752  
E hënë, 7 nëntor 2022  
çmimi 0.40

## Bideni dhe Trumpi kryesojnë tubimet përfundimtare elektorale



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# A PO RREZIKOHET STABILITETI NË VERI?




Të dielën në Mitrovicë të Veriut është mbajtur një protestë nga qytetarët e komunitetit serb në Kosovë, të cilët e kanë kundërshtuar vendimin e Qeverisë së Kosovës për reregjistrimin e makinave me targa ilegale serbe në RKS - Republika e Kosovës. Një ditë më parë përfaqësuesit serbë në Kosovë kanë dhënë dorëheqje në pozitat që mbajnë në Qeveri, Kuvend dhe në ato të gjyqësorit e të Policisë së Kosovës në

veri. Kryeministri Kurti ka thënë se përmes vendimit të Listës Serbe, Beogradi zyrtar po dëshiron ta destabilizojë situatën në Kosovë, mirëpo ai ka thënë se "nuk do t'ia dalë në këtë mënyrë". Partitë opozitare kanë kërkuar nga Kurti që të koordinohet për veprime me aleatët ndërkombëtarë, ndërsa ndërkombëtarët po kërkojnë nga Kurti ta shtyjë vendimin për targa

## OPINION

### TROKITJA E "KONFLIKTIT TË FRANC FERDINANDIT" ... F. 6

Shkruan:  
Pandeli MAJKO



## AKTUALE



### SHQIPTOHEN GJOBA PËR SUBJEKTET AFARISTE NË SKENDERAJ F. 5

## EKONOMI



### FMN-ja KËRKON QË BQK-ja TA VAZHDOJË FORCIMIN E MONITORIMIT TË KREDITIMIT DHE LIKUIDITETIT TË BANKAVE F. 7

### INAUGUROHET RRJETI KOMBËTAR PËR HULUMTIM DHE EDUKIM F. 7

## SPORT



### DRITA NDAHET BARAS ME BALLKANIN, FERIZAJ BEFASON LLAPIN F. 10

## MITCHELLI: BE-ja TA SHTOJË PRESIONIN, DIALOGU KOSOVË - SERBI TË PËRFUNDOJË ME NJOHJE



### KOMUNA E DRENASIT URDHËRON KOMPANINË E UJËSJELLËSIT T'I KTHEJË NË GJENDJE TË MËPARSHME RRUGËT E DËMTUARA

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
+389 44 487 200  
+389 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Bideni dhe Trumpi kryesojnë tubimet përfundimtare elektorale

UASHINGTON, 6 NËNTOR - Presidenti Joe Biden dhe ish-presidenti Donald Trump kanë kryesuar përkatësisht tubimet në Nju-Jork dhe Florida në një përpjekje për t'i nxitur mbështetësit e tyre, ndërsa mbeten vetëm dy ditë nga një garë e ngushtë për Kongresin. Bideni ka shkuar në Westchester të Nju-Jorkut, një territor normalisht i sigurt demokrat, po ku republikanët po kërcënojnë të kalojnë në avantazh falë mesazheve të forta ndaj kundërshtarëve politikë, duke i cilësuar ata si të butë ndaj krimit dhe inflacionit. Guvernatorja demokrate e Nju-Jorkut, Kathy Hochul, po përballet me një sfidë të fortë përballë republikanin Lee Zeldin. Po kështu në të gjithë shtetin po zhvillohen beteja të ashpra edhe për sa i takon garës për një vend në Dhomën e Përfaqësuesve. Ndërkohë, Trumpi ka shkuar në një tubim në Majemi. Florida për disa vjet me radhë ka lëvizur nga partia në parti, por kohët e

fundit po anon drejt republikanëve. Shteti nuk konsiderohet fushëbetejë për këto zgjedhje. Sipas këshilltarëve, tubimet e shpeshta të ish-presidentit Trump i kanë shërbyer atij për të siguruar vëmendje teksa planifikon të nisë një garë të tretë për Shtëpinë e Bardhë pas zgjedhjeve të 8 nëntorit. Florida në veçanti mund të shërbejë si një fushëbetejë e rëndësishme në çdo garë për t'u kandiduar zyrtarisht nga partia për Shtëpinë e Bardhë dhe guvernatori republikan i Floridës, Ron DeSantis, shihet si një nga pretendentët e fortë për t'u kandiduar, nëse ai vendos ta bëjë një gjë të tillë. Kjo e ka shndërruar zotin DeSantis në objektin gjithnjë e më të shpeshtë të kritikave të Trumpit. Figura kryesore demokrate dhe republikane kanë bërë fushatë intensive javët e fundit. Si Trumpi ashtu edhe Bideni u shfaqën në Pensilvani të shtunën, ashtu sikurse edhe



ish-presidenti demokrat Barack Obama. Zonja e Parë Jill Biden ka qenë në Teksas të dielën, ndërsa nënpresidentja Kamala Harris në Çikago. Parashikimet dhe sondazhet jopartiake mbi zgjedhjet tregojnë se republikanët janë favoritët më të mëdhenj për ta fituar kontrollin e Dhomës së



Përfaqësuesve, ndërsa flitet për një garë kokë më kokë për Senatën. Kontrolli, qoftë dhe i njërës prej këtyre dhomave të Kongresit, do t'u jepte republikanëve fuqinë për ta bllokuar agjendën legjislative të Bidenit dhe për të nisur hetime potencialisht të dëmshme ndaj tij. Në disfavor të demokratëve

është edhe rënia e popullaritetit të presidentit Biden. Sipas një sondazhi të fundit të agjencisë 'Reuters' dhe kompanisë 'Ipsos', vetëm 40 % e amerikanëve e mbështesin atë për punën që po kryen në Shtëpinë e Bardhë, gjë që ka bërë që Bideni ta shmangë pjesëmarrjen në fushata elektorale në disa shtete fushëbetejë.

## Samiti për klimën nis punimet në Egjipt me thirrjet për veprim



KAJRO, 6 NËNTOR - Samiti vjetor i Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimatike, ka nisur punimet këtë vit në Egjipt, me thirrjet që vendet të kalojnë "nga epoka e zotimeve në epokën e zbatimit". Më shumë se 120 liderë botërorë pritet të mbajnë fjalime në këtë konferencë, e njohur si COP27. Në këtë organizim pritet të marrin pjesë më shumë se 40 000 njerëz, mirëpo disa aktivistë kanë shprehur shqetësime për historikun e Egjiptit në fushën e të drejtave të njeriut. Në hapje të konferencës OKB-ja e ka publikuar raportin e ri në të cilin është përshkruar "kaosi klimatik". Në konferencë është bërë thirrje që kriza me energji dhe ajo e ushqimit të lidhura me luftën e Rusisë në Ukrainë të mos ndikojnë në marrjen e masave

për t'i luftuar ndryshimet klimatike. Nevoja për marrje të masave është theksuar edhe në raportin e fundit të Agjencisë së OKB-së për Motin. Në të shkencëtarët kanë vlerësuar se temperatura globale e Tokës është rritur për 1.15 gradë celsius prej epokës paraindustriale dhe se tetë vjetët e fundit janë më të nxehtit në histori. Urgjenca për t'u marrë me këtë çështje ka qenë e evidente në 12 muajt e fundit për shkak të vërshimeve shkatërruese në Pakistan, si dhe pas të nxehtit ekstrem në Indi dhe Evropë verën që kemi lënë pas. Liderët botërorë do të flasin në këtë konferencë të hënën dhe të martën dhe, pas largimit të tyre, delegacionet do t'i nisin negociatat se çfarë mund të bëjnë.

## Klitschko: Kievi mund të mbetet pa energji dhe pa ujë

Kiev, 6 nëntor - Kryetari i Kievit, Vitali Klitschko, ka thënë se nuk mund ta përjashtojë mundësinë që kryeqyteti ukrainas të mbetet pa rrymë dhe ujë si pasojë e sulmeve

shkatërruese ruse në infrastrukturën e energjisë. "Ne jemi duke bërë gjithçka që kjo të mos ndodhë mirëpo, të jemi të sigurtë, armiqët tanë janë duke bërë gjithçka për ta lënë këtë

qytet pa ngrohje, rrymë dhe ujë, ashtu që të gjithë ne të vdesim. Ne nuk jemi duke e përjashtuar këtë gjë, prandaj jemi duke shqyrtuar skenarë të ndryshëm për të qenë të përgatitur", ka thënë

Klitschko. Ukraina është përballur me ndërprerje të rrymës dhe ujit prej kur Rusia ka nisur sulmet me raketa dhe dronë në objektet e energjisë muajin e kaluar.



# Trokitja e “Konfliktit të Franc Ferdinandit” ...



**Shkruan: Pandeli MAJKO**

Aksioni i braktisjes së institucioneve nga serbët në Kosovë është një aksion i organizuar nga Beogradi zyrtar. Konflikti shqiptaro-serb ka cilësinë e pandryshueshme në të cilën serbët sillen si viktima dhe shqiptarët, në fund, numërojnë jetët e humbura nga radhët e tyre.

Sjellja e politikës serbe në Ballkan nga krijimi i shtetit të saj ka qenë dhe është e mbështetur te dhuna, si arsytet që vendos për rezultatin përfundimtar.

Kjo që po ndodh aktualisht në Kosovë është rezultat i kthimit të statusit të “të fortit” në kulturën politike. Sjellja e papërgjegjshme e politikanëve serbë në Kosovë, e cila justifikohet me “krizën e targave” të makinës, është ironi

për t’u marrë seriozisht.

Në këtë moment vlen të verifikohet fakti se kombi që nisi Luftën e Parë Botërore në Sarajevë, po tenton ta përsërisë sërish atë.

Mungesa e guximit për ta pranuar realitetin e pas luftës në ish-Jugosllavi, dhe ndërtimi i një bote virtuale për veten, janë shkaktarët realë pse politika serbe rrezikon rajonin me një konflikt të përsëritur ndërkombëtar.

Ajo që mund të fillojë në Mitrovicë duket, në pamje të parë, si një skandal “të fortësh” të cilët duan t’i vënë flakën një realiteti të cilin refuzojnë që ta pranojnë.

Me “të fortët” sjellja diplomatike nuk funksionon. Ajo thjesht ju jep justifikim se në ndeshjen e dëshiruar prej tyre, ata janë fituesit e saj. Dhe çfarë është më e keqja, ajo që vjen më pas do të jetë kërkesa për më shumë se sa ajo që u ofrohet.

Serbia po tenton shkatërrimin e statuskuosë në rajon. Kjo do të ketë, në kushte ekstreme, pasoja me një gjakderdhje pa rregulla e cila do të shpërndahet si sëmundje në rajon.

Shqiptarët nuk kërkojnë më shumë se çfarë kanë aktualisht.

Tregimi i tyre si “kokëfortë” veç bën një barazim të padobishëm midis qëllimit shqiptar për paqen dhe atij serb për mospranimin e statusit që paqja u ka krijuar në rajonin e Ballkanit.

Moska është në pritje të konflikteve të cilat do ta ndihmojnë në situatën që e krijoji vetë me luftën pushtuese në Ukrainë. Strategjia e saj nuk funksionon vetëm në kontratat shtetërore me Serbinë. Mobilizimi i kriminelëve nga burgjet i cili turpëron historinë e ushtrisë ruse tregon se gangsterët po kthehen në një kulturë veprimi praktik.

Është mbivlerësues fakti që Beogradi ka mundësi ta kontrollojë një konflikt shqiptaro-serb. E kundërta është e vërtetë. Ky konflikt do t’i ketë vetëm jetët e humbura si statistikë.

Diplomacia lineare evropiane është ende e papërgatitur për një konflikt të tillë i cili mund ngajë ajsbergut ku u përplas Titaniku.

Nëse një konflikt hipotetik midis Arabisë Saudite dhe Iranit do të shkatërronte tregun ndërkombëtar të energjisë, ai shqiptaro - serb do të ftonte

kaosin në rregullat ndërkombëtare të trajtimit të krizave.

Të papërgjegjshëm dhe me jetë të dyfishtë midis Lindjes dhe Perëndimit, politikanët drejtues të Serbisë nuk janë të qartë për fundin e kësaj që ka nisur në Kosovë. Zgërdhirja “lindore” në prapaskenë dhe fytyra e pezmatuar “perëndimore” në publik, po e kthen politikën serbe në një mallkim për vetveten.

Serbët nuk kuptohen çfarë duan. Ata dinë vetëm të kundërtën. Ky është fati i një kombi që ka humbur rrugën dhe çdo sukses e mat me përfitimin financiar.

Kjo që po ndodh në Kosovë kërkon mjaft gjakftohtësi. Dhe sa më pak “deklarime trimash”. Jemi në prag të një kaosi pa fitimtarë. Ai mund të fillojë për shkak të rrethanave dhe perceptimit që palët kanë mbi mundësitë e veta. Sikur kjo që po ndodh në Kosovë të ishte një histori “gjelash” midis shqiptarëve dhe serbëve, ajo do të ishte e thjeshtë. Por, ja që nuk është kështu.

Strategjia e palës së padukshme në këtë situatë mund ta zhysë rajonin në një luftë, e cila, pas

një muaji, do ta ketë të vështirë kujtesën se për çfarë arsye ajo filloi.

Gangsterët, si rregull, duan luftëra të pjesshme me fitime të garantuara. “Mungesa e fitimit” prej saj nesër, është mundësia e diplomacisë sot. Çdo tentativë për trajtim të njëjtë të palëve sipas parimeve teorike të trajtimit të barabartë nxit kulturën e gangsterit në Ballkan. Kosova ka mbrojtjen legale të NATO-s. Problemi i Aleancës aktualisht nuk është Kosova, por Ukraina. Një shpërthim i pakontrolluar në Kosovë e kthen çështjen në ushtarake. Bëjnë mirë që të mos presin kush do të jetë Duka Franc Ferdinand... i kohës sonë.

Nëse fillon konflikti, Prishtina dhe Beogradi duhet të bëhen gati për ushtarë të huaj që vriten me njëri-tjetrin për qëllime që nuk kanë të bëjnë vetëm me ta. Ky skenar është mirë që të mendohet dhe të mendohet mirë.

Ushtarët e huaj nuk do të marrin urdhra nga politikanët serbë apo shqiptarë. Nëse fillon kaosi, ata do të jenë “jashtë kohe”. Paqen do ta vendosin ushtarakët ashtu si në vitin 1999.

## Mitchelli: BE-ja ta shtojë presionin, dialogu Kosovë - Serbi të përfundojë me njohje

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Ish-ndihmësekretari i shtetit në administratën e Donald Trumpit, Wess Mitchell, ka folur për zhvillimet në Kosovë dhe Serbi. Zgjidhjen e problemit ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit e sheh me njohje nga Serbia dhe 5 vendet e BE-së. “Të gjithë e dimë se pa njohje nuk do të ketë hapa të Kosovës drejt OKB-së dhe as hapa të Serbisë drejt BE-së. Në aspekt afatgjatë nuk është në interes të askujt që Serbia të varet nga ndihmat evropiane kur, njëkohësisht, ka lidhje të forta me Rusinë dhe Kinën për energji dhe që Kosova të mbetet një ekonomi e varur nga ndihmat e huaja dhe remitancat”, është shprehur ai. Duke pasur parasysh situatën në Ukrainë, diplomati amerikan thotë se Ballkani Perëndimor mund të jetë në rrezik për destabilizim. “Është e qartë që Vladimir Putini mund të krijojë paqëndrueshmëri në Ballkanin Perëndimor, por mendoj se lufta në Ukrainë ka krijuar mundësi për një diplomaci shumë më kreative dhe shumë më agresive në rajon. Mendoj se Vuçiqi është mbështetur pas muri dhe ka më pak linja varësie të mbështetjes ruse sesa nga e kaluara. Kjo mund ta shtyjë atë që të jetë më



konstruktiv, por nevojitet që Perëndimi të bëjë më shumë presion”, theksoi Mitchell. Megjithatë, Mitchell nuk pret një kthim të shpejtë të Serbisë

nga Perëndimi. “Serbia është e njohur për lojën e balancimit me të gjitha palët - Rusinë, Kinën, BE-në, ShBA-në. Kjo është një lojë e vjetër dhe shumë e njohur.

Ajo që mund të them me besim të plotë është se Serbia nuk ka të ardhme të qëndrueshme përveçse me Perëndimin. Rusia nuk është një treg i

qëndrueshëm për Serbinë në të ardhmen afatgjatë. Mendoj se serbët e dinë këtë”, ka deklaruar ai në një intervistë për “Euronews Albania”.



# A po rrezikohet stabiliteti në veri?

Të dielën në Mitrovicë të Veriut është mbajtur një protestë nga qytetarët e komunitetit serb në Kosovë, të cilët e kanë kundërshtuar vendimin e Qeverisë së Kosovës për reregjistrimin e makinave me targa ilegale serbe në RKS - Republika e Kosovës. Një ditë më parë përfaqësuesit serbë në Kosovë kanë dhënë dorëheqje në pozitat që mbajnë në Qeveri, Kuvend dhe në ato të gjyqësorit e të Policisë së Kosovës në veri. Kryeministri Kurti ka thënë se përmes vendimit të Listës Serbe, Beogradi zyrtar po dëshiron ta destabilizojë situatën në Kosovë, mirëpo ai ka thënë se “nuk do t’ia dalë në këtë mënyrë”. Partitë opozitare kanë kërkuar nga Kurti që të koordinohet për veprime me aleatët ndërkombëtarë, ndërsa ndërkombëtarët po kërkojnë nga Kurti ta shtyjë vendimin për targa

**EPOKA  
ERE****Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 6 NËNTOR** - Të dielën në Mitrovicë të Veriut është mbajtur një protestë nga qytetarët e komunitetit serb në Kosovë. Ata kanë kundërshtuar vendimin e Qeverisë së Kosovës për reregjistrimin e makinave me targa ilegale serbe në RKS - Republika e Kosovës. Përfaqësuesit serbë në Kosovë kanë vendosur në të shtunën e 5 nëntorit që të mos jenë më pjesë e institucioneve të këtij shteti.

Kryetari i Listës Serbe, Goran Rakiq, ka thënë se dorëheqjet përfshijnë pozitat në Qeverinë

dhe Kuvendin e Kosovës dhe në ato të gjyqësorit e të Policisë së Kosovës në veri. Katër komunat me shumicë serbe në veri janë: Mitrovica e Veriut, Zveçani, Leposaviqi dhe Zubin Potoku. Serbët e Kosovës nuk e mbështetin vendimin e Qeverisë së Kosovës për reregjistrimin e makinave me targa ilegale serbe në targa RKS - Republika e Kosovës. Besohet se në Kosovë janë rreth 10 000 makina me targa serbe. Goran Rakiq, kryetari i Listës Serbe, ka thënë, pas një takimi me dyer të mbyllura, se vendimi do të zbatohet derisa Qeveria e Kosovës ta tërheqë vendimin për reregjistrim të makinave dhe

t’i respektojë marrëveshjet e Brukselit.

## **Kurti: Ligjshmëria dhe kushtetutshmëria e Kosovës nuk mund të komprometohen**

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të dielën se është në kontakt të vazhdueshëm me organet e sigurisë ndërkombëtare për ta garantuar stabilitetin në Kosovë. Ai i ka bërë këto deklarata pas pyetjeve lidhur me situatën e sigurisë në Kosovë. “Situata e sigurisë në Republikën e Kosovës rrezikohet nga individë e grupe të ndryshme të kriminalizuara. Që një vjet e tetë muaj sa qeverisim kemi bërë avancimin më të madh në luftimin e krimit dhe korrupsionit, sidomos në aspektin ekonomik”, ka deklaruar Kurti.

Ai ka thënë se ligjshmëria dhe kushtetutshmëria e Kosovës nuk mund të komprometohen. “Ato shkojnë bashkë me paqen dhe sigurinë. Nuk do të ketë individ dhe asnjë grup më të fuqishëm sesa shteti. Ne nuk i dallojmë kriminelët në bazë të përkatësisë etnike, por vetëm në bazë të veprave të tyre penale”.

I pyetur për vendimin e Listës Serbe - partisë më të madhe të serbëve në Kosovë - për t’u larguar nga institucionet e Kosovës, Kurti ka përsëritur thirrjen e një dite më parë që serbët të mos veprojnë ashtu, sepse do ta dobësojnë shërbimin për qytetarët. Sipas tij, përmes vendimit të Listës Serbe, Beogradi zyrtar dëshiron ta destabilizojë situatën në Kosovë, mirëpo Kurti ka thënë se “nuk do t’ia dalë në këtë mënyrë”. “Ka mundësi që ata nuk dëshirojnë të angazhohen në mënyrë konstruktive në dialog dhe tash kanë zgjedhur rrugën tjetër, por unë besoj se të dëgjueshëm ndaj tyre janë pakrahasimisht më shumë strukturat e ndryshme ilegale sesa qytetarët të vendit tonë të cilët janë serbë”.

## **Opozita, thirrje Kurtit: Koordinohu me ShBA-në**

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka theksuar se zhvillimet në veri të vendit shënojnë një akt të paprecedent jo vetëm të cenimit të sovranitetit juridik e shtetëror të Republikës së Kosovës, por edhe të cenimit të rendit publik i cili është bazë për sigurinë e jetës së të gjithë qytetarëve të asaj zone pa dallim. “Jam jashtëzakonisht i shqetësuar

me këto zhvillime dhe në rrethanat kur nuk ka një epilog të qartë rreth tyre, është obligim i qeverisë që t’u japë sqarime qytetarëve se çfarë në të vërtetë është duke ndodhur atje. Prandaj, kërkoj nga kryeministri i Kosovës, z. Albin Kurti, që t’u drejtohet qytetarëve e t’i njoftojë për seriozitetin e situatës dhe për hapat që do të ndërmarrin institucionet e vendit për ta garantuar ruajtjen e rendit publik, jetës së qytetarëve dhe sovranitetit të vendit”, ka thënë Krasniqi. Ai ka shtuar se situata është duke ndryshuar nga ora në orë dhe rreziku i përshkallëzimit është i mundshëm.

Edhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka reaguar për situatën në veri. Sipas kësaj partie, në kohën e zhvillimeve të fundit në veri të vendit, Kosovës i duhet udhëheqje e matur që nuk bie në grackat destabilizuese të Serbisë, por që synim ka integrimin e vazhdueshëm e të plotë të serbëve të Kosovës e që mjet të domosdoshëm ka koordinimin e ngushtë me aleatë ndërkombëtarë. “Politikat populiste, me synim turmat partiake para interesave madhore nacionale, i sjellin Kosovës dëm afatgjatë dhe regres në arenën ndërkombëtare. LDK-ja i fton qytetarët në veri për qetësi,

ndërsa institucionet e Republikës për koordinim të ngushtë me ShBA-në dhe aleatët e tjerë evropianë. Moskoordinimi me aleatët tanë ndërkombëtarë nga institucionet e Republikës së Kosovës, i nxitë dhe u shërben agjendave destabilizuese dhe provokuese në territorin e Kosovës. Pasojat e një destabilizimi të tillë janë të pariparueshme për vendin”, është thënë në reagimin e LDK-së.

Ndërkaq lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka theksuar se populli i Kosovës dhe aleatët tanë të sigurisë i dinë shumë mirë qëllimet e Serbisë, sponsorëve dhe satelitëve të saj. Por, sipas tij, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përmes zyrtarëve të saj, që nga ambasadori Hovenier e deri te sekretari i Shtetit, Blinken, kërkuar nga Kosova pezullimin e vendimit për targa deri në marrëveshjen finale. “Kësaj kërkesë iu bashkuan edhe vendet e tjera të NATO-s, aleate tonat në siguri. Kjo kërkesë nuk është vetëm politike, por garanton sigurinë e vendit tonë, veçanërisht sigurinë e rendin në veri të vendit. Ata që dalin jashtë kësaj kërkesë nuk punojnë në interes të sigurisë së vendit tonë e as të zbatimit të ligjit. Kurti me demagogët e vet, qoftë në qeveri e qoftë jashtë saj, nuk janë me aleatët e sigurisë dhe as nuk janë të

interesuar për sigurinë e Republikës së Kosovës”, ka deklaruar Haradinaj. Ish-kryeministri Haradinaj ka pohuar se kjo situatë është bardh e zi. “Në vend që të vazhdohet me demagogji, menjëherë duhet të pranohet kërkesa e Amerikës, e Quintit dhe aleatëve të tjerë të NATO-s për shtyrjen e vendimit për targa deri në marrëveshjen finale për njohje reciproke në mes të Kosovës dhe Serbisë”, ka theksuar Haradinaj.

### Hill: Serbët të kthehen në institucione, Kosova t'i respektojë obligimet

Shtetet e Bashkuara pajtohen me Bashkimin Evropian që zhvillimet e fundit në marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Serbisë rrezikojnë

përparimin e rëndësishëm që është arritur në dialogun mes këtyre dy vendeve nën ndërmjetësimin e bllokut evropian.

Kështu ka thënë të dielën ambasadori amerikan në Beograd, Christopher Hill. Ai i ka bërë këto deklarata një ditë pas vendimit të Listës Serbe - partisë më të madhe të serbëve në Kosovë - për t'u larguar nga institucionet e Kosovës. “Tërheqja e serbëve nga institucionet e Kosovës nuk është zgjidhje për mospajtimet aktuale dhe ka potencial për t'u përshkallëzuar edhe më shumë tensionet. Shtetet e Bashkuara i bashkohen BE-së në thirrjen që përfaqësuesit e Kosovës dhe Serbisë të veprojnë në përputhje me përkushtimet e bëra në dialog dhe që t'u kthehen institucioneve të Kosovës,

duke përfshirë policinë, gjyqësorin dhe administratën lokale”, ka thënë Hill për televizionin N1.

Paralajmërimet e Listës Serbe për largim nga institucionet e Kosovës kanë ardhur pas vendimit të autoriteteve të Kosovës për suspendimin e drejtorit të Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Nenad Gjuriq, i cili ka refuzuar ta zbatojë vendimin e Qeverisë së Kosovës për reregjistrimin e makinave që kanë targa të lëshuara nga Serbia në RKS - Republika e Kosovës.

### Borrelli: Zhvillimet e fundit rrezikojnë përparimin e arritur në dialog

Shefi i diplomacisë i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, u ka bërë thirrje Prishtinës dhe Beogradit që të përmbahen nga çfarëdo veprimi i njëanshëm që mund t'i rrisë tensionet. Ai i ka bërë këto deklarata pas vendimit të Listës Serbe, partisë më të madhe të serbëve në Kosovë, për t'u larguar nga institucionet e Kosovës. Borelli ka thënë se largimi i serbëve nga institucionet e Kosovës nuk është zgjidhje për mospajtimet aktuale. “Zhvillimet e fundit rrezikojnë punën e madhe që është bërë në kuadër të dialogut në mes të Beogradit dhe Prishtinës”, ka

thënë ai. Në deklaratën e BE-së është përmendur, po ashtu, kërkesa ndaj autoriteteve të Kosovës për ta shtyrë afatin e reregjistrimit të makinave dhe që t'i pezullojnë masat ndëshkuese ndaj pronarëve që kanë makina me targa serbe. “Çështja e targave mund të zgjidhet nga palët në kuadër të dialogut”, është thënë në deklaratë.

### KFOR-i i gatshëm të intervenojë nëse rrezikohet stabiliteti

Zëvendëssekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mircea Geoana, ka thënë të shtunën se misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR-i, mbetet vigjilent dhe i gatshëm për të intervenuar në rast se rrezikohet stabiliteti. Përmes një postimi në “Twitter”, ai ka thënë se ka biseduar me të dërguarin special të Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor, Miroslav Lajçak, lidhur me situatën, siç ka thënë ai, të tensionuar në veri të Kosovës. “Beogradi dhe Prishtina duhet të tregojnë përmbajtje dhe ta parandalojnë përshkallëzimin”, ka thënë ai.

Ndërkohë Lajçaku ka thënë se pajtohet plotësisht me qëndrimet e zyrtarit të NATO-s dhe është mirënjohës për bashkëpunimin e BE-së me aleancën veri-atlantike dhe KFOR-in.

## Plani për targa

Prej 1 nëntorit Qeveria e Kosovës ka nisur ta zbatojë planin e saj - në tri faza - për reregjistrimin e makinave me targa të lëshuara nga Serbia. Faza e parë përfshin qortimin e shoferëve, e dyta parashihet gjohë deri në 150 euro për ata shoferë, e treta targa provuese.

Zbatimi i këtij plani pritet të përfundojë më 21 prill dhe, nga kjo datë, në qarkullim do të lejohen vetëm makina me targa RKS.

Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian kanë shprehur zhgënjim pse Qeveria e Kosovës nuk ka vepruar në përputhje me kërkesën e tyre për ta shtyrë për 12 muaj vendimin për targa.



## Komuna e Mitrovicës nënshkruan marrëveshje bashkëfinancimi me Islamic Relief

**MITROVICË, 6 NËNTOR** - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me drejtorin e organizatës "Islamic Relief Kosova", Mohamed Soliman, për bashkëfinancimin e projektit "Grante bujqësore" në Komunën e Mitrovicës. Pjesë e këtij takimi ishte edhe drejtori i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Ferdi Kadriu. Qëllimi i nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje është mbështetja me grante bujqësore për familjet në nevojë në komunën e Mitrovicës, ku në këtë mënyrë do të ndihmohet zhvillimi i bujqësisë dhe fuqizimi i ekonomive familjare në qytetin e Mitrovicës. Vlen të theksohet se për

realizimin e këtij projekti komuna e Mitrovicës do të participojë në shumën prej 130,368.00 eurosh ose 41.67 për qind të vlerës totale, ndërsa "Islamic Relief Worldwide" - Zyra në Kosovë - do ta sigurojë pjesën e fondeve në vlerë prej 182,515.20 eurosh ose 58.33 për qind. Vlera e përgjithshme për zbatimin e këtij projekti arrin shifrën mbi 300 mijë euro.

Me këtë rast, kryetari Hamza ka falënderuar organizatën në fjalë për bashkëpunim dhe mbështetjen e dhënë për realizimin e projekteve në sektorin e bujqësisë ku, përveç kësaj marrëveshjeje, "Islamic Relief Kosova" do të financojë me grante edhe tre të rinj ndërmarrës mitrovicas.



## Komuna e Drenasit urdhëron kompaninë e ujësjellësit t'i kthejë në gjendje të mëparshme rrugët e dëmtuara



**DRENAS, 6 NËNTOR** - Drejtoria e Inspeksionit në Drenas, pas ankesave të shumta të qytetarëve për dëmtimin e rrugëve nga Kompania e Ujësjellësit Rajonal "Prishtina" - njësi në Drenas, më 12.10.2022, përmes një aktvendimi ka urdhëruar kompaninë, që disa nga sipërfaqet e rrugëve të cilët i ka dëmtuar gjatë punimeve të rrjetit të ujësjellësit, t'i rikthejë në gjendjen e mëparshme. Tashmë kompania ka filluar

punimet dhe Drejtoria për Inspeksion është duke monitoruar dëmtimet në së paku dhjetë rrugë të komunës në disa fshatra dhe në disa rrugë brenda qytetit të Drenasit e të cilat ka kërkuar nga kompania që të riparohen menjëherë. "Duke e ditur se disa nga punimet e kompanisë së ujësjellësit në rrugë datojnë që dy apo tri vjet, kërkojmë nga qytetarët që në ato pjesë ku nuk kemi mundur ta identifikojmë dëmtimin e

rrugës nga kompania në fjalë, të bashkëpunojnë me Drejtorinë për Inspeksion dhe t'i marrim masat e duhura për riparimin e tyre. Inspektorët në vazhdimësi kanë pranuar ankesa nga qytetarët lidhur me këtë problem andaj janë ndërmarrë masa të duhura konform ligjit, që gjendja e këtyre rrugëve të përmirësohet dhe kompania ta marrë përgjegjësinë e saj", ka njoftuar komuna e Drenasit.

## Shqiptohen gjoba për subjektet afariste në Skenderaj

**SKENDERAJ, 6 NËNTOR** - Drejtoria e Inspeksionit e komunës së Skenderajt u ka shqiptuar gjobë dy subjekteve afariste që operojnë në qytet, (njëra është dënuar me 600 euro, tjetra me 500), pasi është konstatuar se kanë bërë shkelje të Ligjit për Mbrojtje të Konsumatorit. Më saktësisht, subjektet afariste nuk kanë harmonizuar çmimin e produktit të ekspozuar në raft me arkën e shitjes. Në aktvendimin e Drejtorisë

së Inspeksionit, mes të tjerash, thuhet: "Pas ankesës së konsumatorit në Drejtorinë e Inspeksionit, që në zbritjen e datës 1 nëntor, produkti supë gjeli ka qenë në zbritje nga 0.47 euro, në 0.29 euro, në arkë konsumatori ka paguar për të njëjtin produkt 0.35 euro (dëshmi kuponi fiskal)".

Në të dy subjektet afariste, ndaj të cilave është shqiptuar gjobë, është konstatuar natyrë e njëjtë e parregullsisë. Deri

te konstatimi i këtij veprimi, që bie në kundërshtim me ligjin për mbrojtjen e konsumatorit, ka ardhur pas bashkëpunimit nga ana e qytetarëve me organet kompetente për t'i denoncuar këto parregullsi.

Komuna e Skenderajt dhe Drejtoria e Inspeksionit falënderojnë qytetarët për bashkëpunim dhe ftojnë të paraqesin çdo rast që bie ndesh me ligjet e aplikueshme në vendin tonë.



## Shefja e UNMIK-ut vizitoi Kamenicën



**KAMENICË, 6 NËNTOR** - Kryetari i komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj, ka prituri në takim shefen e UNMIK-ut, Caroline Ziadeh, së bashku me përfaqësues të tjerë. Kryetari Rahimaj ka theksuar se kjo vizitë ka qenë e karakterit njoftues dhe

bashkëpunues në të gjitha fushat, përfshirë këtu edhe digitalizimin e sistemit arsimor. Pas takimit, Ziadeh ka vizituar edhe tregun shumetnik ku, ndër të tjera, është shprehur se jetesa ndëretnike është vlerë për siguri dhe mirëqenie.

# FMN-ja kërkon që BQK-ja ta vazhdojë forcimin e monitorimit të kreditimit dhe likuiditetit të bankave

**EPOKA  
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti dhe shefi i misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar për Kosovën, Gabriel di Bella, kanë paraqitur deklaratën përmbyllëse të misionit të FMN-së në kuadër të Artikullit IV.

Guvernatori Mehmeti ka thënë se BQK-ja ka vazhduar të jetë e angazhuar për realizimin e detyrave të saj në mbajtjen dhe ruajtjen e një sistemi financiar stabil dhe vazhdimisht në rritje. Ai ka thënë se sistemi financiar në Kosovë ka vazhduar të jetë likuid dhe mirë i kapitalizuar ku në të gjithë indikatorët ka shënuar rritje dyshifrore, duke qenë një nga faktorët e rëndësishëm për rritjen dhe zhvillimin ekonomik të vendit. "Gjithsej mjetet e sistemit financiar në vend, më 31 gusht 2022, kanë arritur vlerën e përgjithshme prej 9.3 miliardë eurosh. Ndërsa mjetet e sektorit bankar kanë vazhduar trendin e rritjes edhe gjatë vitit 2022, duke arritur vlerën rreth 6.4 miliardë euro në muajin gusht 2022, e cila paraqet një rritje vjetore prej 11.1-përqindësh.

Në gusht 2022 vlera e përgjithshme e depozitave është në vlerë prej 5.2 miliardë eurosh, që paraqet një rritje vjetore prej 11.8-përqindësh, derisa rritja e depozitave ka vazhduar edhe gjatë muajit shtator, prej 12.7-përqindësh", ka thënë Mehmeti.

Ai ka theksuar se sektori bankar vazhdon të jetë i qëndrueshëm duke rritur aktivitetin kredidhënës dhe duke luajtur rol shumë të rëndësishëm në kreditimin e ekonomisë së vendit edhe gjatë këtij viti. "Vlera e portofolit kreditor të sektorit bankar në fund të gushtit 2022 ishte në shumën prej 4.2 miliardë eurosh, me një rritje vjetore prej 18.6-përqindësh, derisa norma mesatare e interesit për kredi ishte 6 për qind", ka deklaruar guvernatori Mehmeti.

Ai ka thënë se kreditë joperformuese kanë vazhduar trendin rënës dhe sot norma e kredive joperformuese është në nivelin prej 2.1-përqindësh, që është tregues dukshëm më i mirë krahasuar me vendet e regjionit apo dhe më gjerë. "Gjithashtu, sektori bankar vazhdon të jetë mirë i kapitalizuar dhe likuid, ku treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit për sektorin bankar shënon 16.1 për qind, që është



dukshëm mbi kërkesat rregullatore prej 12-përqindësh, ndërsa treguesi i likuiditetit është 35.7 për qind, ngjashëm më lart se kërkesa rregullatore prej 25-përqindësh", ka thënë ai. Para mediejeve guvernatori ka folur edhe për sektorin e sigurimeve, i cili ka pasur rezultate pozitive. Guvernatori Mehmeti ka falënderuar përfaqësuesit e Fondit Monetar Ndërkombëtar për kontributin dhe përkrahjen e vazhdueshme të Kosovës dhe

të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Nga ana tjetër, shefi i misionit të FMN-së për Kosovën, Gabriel di Bella, ka thënë se sektori financiar ka përballuar tronditjet që goditën ekonominë dhe ndër faktorët që kanë ndikuar, kanë qenë politikat e ndjekura nga BQK-ja. Di Bella ka shtuar se pavarësia e BQK-së është gurthemeli bazë i politikave ekonomike të Kosovës. Në deklaratën përmbyllëse të Misionit, në kuadër të Nenit IV

për vitin 2022, është kërkuar që BQK-ja të vazhdojë ta forcojë monitorimin e kreditimit dhe likuiditetit të bankave dhe ruajtjen e dinamikës së mirë të Rishikimit të Stabilitetit të Sektorit Financiar 2019 (FSSR). FMN-ja pret që BPV-ja reale të shënojë rritje prej 3-4-përqindësh në vitin 2023 dhe inflacioni gradualisht të lehtësohet, por këto parashikime në thelb varen nga çmimet ndërkombëtare të mallrave, përfshirë energjinë.

## Inaugurohet Rrjeti Kombëtar për Hulumtim dhe Edukim

PRIZREN, 6 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci dhe menaxheri i Zyrës së Bankës Botërore për Kosovë, Massimiliano Paolucci, kanë inauguruar Rrjetin për Hulumtim dhe Edukim të Kosovës (KREN).

Në ceremoninë e inaugurimit të mbajtur në Parkun për Inovacion dhe Trajnime në Prizren, kryeministri Albin Kurti tha se sot po kurorëzohet suksesin e radhës, krijimin e rrjetit kombëtar për hulumtim dhe edukim, me të cilin rrjet Kosova është kyçur në rrjetin akademik panevropian, i cili do të luajë një rol të rëndësishëm për hulumtime shkencore.

Duke folur për sukseset e Kosovës në shtrirjen e rrjetit të internetit, kryeministri Kurti tha se Kosova është kampione në Ballkan dhe e krahasueshme me shtetet evropiane për shtrirjen e rrjetit dhe së shpejti do ta festojmë edhe lidhjen e

fundit të fshatrave në rrjet.

Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, theksoi se dedikimi dhe puna jonë fokusohen në zhvillim të shtrirjes e të përmirësimit të infrastrukturës digjitale për ta shtyrë para transformimin digjital të vendit e për ta mundësuar realizimin e plotë të potencialit të rinisë sonë të talentuar.

Ministrja Rizvanolli tha se me KREN-in studentët e hulumtuesit do të kenë qasje në laboratorë virtualë, softuerë, trajnime të avancuara e projekte të përbashkëta kërkimore me kolegët në gjithë Evropën.

Po ashtu, ministrja Rizvanolli njoftoi se me KREN-in do të lidhen edhe të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të Kosovës, ndërsa deri më tani janë nënshkruar memorandume bashkëpunimi me 16 universitete dhe kolegje në Kosovë duke u pajtuar për zotime dhe angazhime të dyja palët.

Ndërsa ministrja Arbërie Nagavci theksoi se në



Strategjinë e Arsimit 2022-2026 që është hartuar, digjitalizimi është ndër elementet thelbësore të kësaj strategjie dhe është shtylla e pestë e Strategjisë.

Për ta rritur cilësinë e mësimin, ajo tha se është e rëndësishme që institucionet tona arsimore të digjitalizohen dhe në pesë vjetët në vijim synohet të

arrihet kjo, duke i digjitalizuar të gjitha institucionet shkollore. Projekti KREN është realizuar nga Ministria e Ekonomisë dhe është mbështetur nga Banka Botërore. Në sistemin KREN do të jenë të lidhura të gjitha universitetet e Kosovës, së shpejti do të lidhen të gjitha institucionet shkollore dhe do të shfrytëzohet nga Ministria e

Arsimit për shpërndarjen e Kurikulës Digjitale.

Po ashtu, me KREN-in studentët dhe hulumtuesit do të kenë qasje në laboratorë virtualë, trajnime softuerike të avancuara dhe projekte të përbashkëta kërkimore me kolegët nga e gjithë Evropa dhe do të ofrohen shumë shërbime të tjera.

REAGIM NDAJ INTERVISTES TË SINAN HASANIT, TË PUBLIKUAR NGA ATV TË GAZETARIT ZEJDUSH KASTRATI!

# INTERVISTA E SINAN HASANIT PAS ÇLIRIMIT TË KOSOVËS NGA SERBIA PUSHTUESE E MBUSHUR ME FYERJE KOMBËTARE



**Ismet SYLEJMANI**

Para disa ditësh në një nga televizionet private në Kosovë, në emisionin që e drejtonte gazetari Resul Sinani, në ATV, u transmetua intervista me Sinan Hasanin e gazetarit Zejdush Kastrati!

Përmendja e emrit të Sinan Hasanit në ekranet televizive, me shpejtësi apo edhe ngadalshëm, hetueshëm apo edhe pahetueshëm, në të dy rastet nuk përben ndonjë lajm me vlerë as historike e as politike, por përkundrazi, është anakronike dhe e mjerueshme, sepse edhe sikur të trajtoheshin figurat tradhetare e të shitura, ky bën pjesë në taborrin e grupit me të madh antishqiptar, më të madh tradhëtar dhe 100% pro pushtues serb!

Shpirti i zi katran i funksionarit shqiptar, projugosllav e proserb Sinan Hasanit edhe në vitin 2005, i thotë Kosovës krahinë, shihet qartë se ka mbetur i akorduar me oren dhe me promemorian fashiste pushtuese serbe mbi Kosovën. Sinan Hasani në pozita proserbe ishte i rangut të Rrahman Morinës, Ali Shukriut, Sejdo Bajramoviqit dhe i shumë të tjerëve, të cilët ishin secili me antishqiptar se tjetri, secili me proserb se tjetri, secili me tradhëtar se tjetri...

Sinan Hasani, ishte politikan kukull në duart e politikës antishqiptare të Serbisë pushtuese, ishte shërbëtor besnik i interesave serbe në Kosovë!

Disponimi i tij gjatë intervistës dhe të shërbyerit me terminologjinë politike të kohës dhe mos dënimi i krimeve serbe mbi popullin e pambrojtur e duarhatë të Kosovës, është tregues se ai nuk ishte i penduar për të kaluarën e tij të poshtër e tradhtare në dëm të popullit



shqiptar të Kosovës dhe viseve tjera shqiptare në ish-jugosllavi.

Është për të ardhur keq që kjo fundrrinë është varrosur në Kosovë dhe është mbuluar me dheun e Kosovës!

Ky ka qene dashur te varroset ne Serbi ashtu sikur tradhetari Rrahman Morina!

Sinan Hasani hapur ka qenë titist!

Sinan Hasani hapur me votën e

tij ka qenë pro mbetjes së Kosovës nën Serbi në Kuvendin e Kosovës në Prizeren në vitin 1945!

Sinan Hasani hapur ka qenë millosheviqist!

Sinan Hasani hapur ka qenë kundër ngjarjeve të vitit 1981!

Sinan Hasani hapur ka qenë për suprimimin e autonomisë së Kosovës në vitin 1989!

Sinan Hasani hapur ka qenë kundër UÇK-së!

Sinan Hasani nuk i ka denuar krimet dhe gjenocidin serb ndaj popullit të tij shqiptar që i përkiste!

Sinan Hasani nuk e ka përshëndetur ndërhyrjen e aleancës ushtarake të NATO-s në Kosovë!

Lëvizja Popullore e Kosovës-LPK, me kohë ka mbajtur qëndrim ndaj figurës se urryer dhe antishqiptare te Sinan Hasanit, i cili gjatë gjithë kohës

sa ishte në pushtet dhe deri kur vdiq, i lënë në harresë dhe i braktisur edhe nga ata që u kishte shërbyer me besnikëri qeni, meritone jo vetëm përbuzje por duhej të ulej në bankën e të akuzuarit dhe ti jepej dënimi i merituar nga drejtësia e Kosovës së çliruar, të lirë e të pavaruar nga Serbia pushtuese!

Prishtinë, 5 Nëntor 2022!



**EURO GLASS**  
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
 Enveri  
 Adr: Fushë Kosovë  
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
 E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJQËSIA'**  
 TEL: 045/82 82 82

## Loriana Kuka e fiton të bronzët

**BAKU, 6 NËNTOR** - Loriana Kuka e ka fituar medaljen e bronzët në Grand Slamin që u mbajt në Baku të Azerbajxhanit. Xhudistja kosovare pati një paraqitje të mirë, duke shënuar tri fitore e një humbje gjithsej

në kategorinë deri në 78 kilogramë. Në raundin e parë, Kuka kaloi pa luftë, kurse në të dytën fitoi me IPPON ndaj gjermanes, Teresa Zenker. Në çerekfinale, ajo triumfoi përballë holandezes, Guusje

Steenhuis, të cilën e mposhti me dy waza-ari. Loriana Kuka u ndal në gjysmëfinale nga xhudistja holandeze, Natascha Ausma, që e mposhti me një waza-ari. Por, në luftë për medaljen e bronzët, Kuka

ishite më e suksesshme sesa anglezja Emma Reid. Kosovon në këtë Grand Slam u paraqit edhe me Nora Gjakovën në kategorinë deri në 57 kilogramë. Kampionia olimpikë arriti të stolisej me medalje të bronzët.



## Drita ndahet baras me Ballkanin, Ferizaj befason Llapin

**PRISHTINË 6 NËNTOR** - Përballja e lidere aktuale të renditjes, Dritës dhe kampionit në fuqi, Ballkanit, ka përfunduar pa fitues. Ndeshja e zhvilluar, të dielën, në Gjilan, në kuadër të javës së 15-të në Albi Mall Superligë, është mbyllur baras 2:2. Drita ishte dy herë në epërsi, por nuk arriti ta ruajë atë. Fillimisht shënoi Besnik Krasniqi nga penalltia, në minutën e 12-të. Por, 11 minuta më vonë shifrat i barazoi Albin Berisha. Në fillim të pjesës së dytë Drita e riktheu epërsinë, me golin e Marko Simonovskit me guajtje me kokë pas harkimit të Selmanit, në minutën e 49-të. Megjithatë, një pikë portokallezinjve ia siguroi sulmuesi i spikatur Albion Rrahmani, në minutën e 74-t, pas minuta pasi u inkuadrua në lojë. Drita edhe më tutje kryeson renditjen, me 31 pikë, katër më shumë se Ballkani. Mirëpo, skuadra e Ilir Dajës nuk i ka zhvilluar tri ndeshje për shkak të



angazhimeve në UEFA Conference League. Befasinë e kësaj jave e ka përgatitur skuadra e fundit në renditje, Ferizaj, që ka

arritur fë fitojë si mysafirë në "Zahir Pajaziti" kundër Llapit, 2:1. Golat për ferizajasit i shënuan Dardan Çerkini dhe Betim

Haxhimusa, derisa golin e vetëm për llapjanët e realizoi Bianor Neto. Ndërkohë, të shtunën, Prishtina barazoi 2:2 në "Fadil

Vokri" kundër Gjilanit, Dukagjini fitoi bindshëm ndaj Malishevës (4:0), teksa Trepça'89 e mundi Drenicën me rezultat të ngushtë (1:0).

SUPERLIGA		
Llapi - Ferizaj		1-2
Drita - Ballkani		2-2
Trepça'89 - Drenica		1-0
Dukagjini - Malisheva		4-0
Prishtina - Gjilani		2-2
Tabela		
	Pikë	
1. Drita	15	31
2. Ballkani	12	27
3. Prishtina	14	23
4. Gjilani	15	23
5. Drenica	15	17
6. Llapi	14	16
7. Malisheva	15	15
8. Dukagjini	15	15
9. Trepça'89	14	15
10. Ferizaj	15	12

## Kampioni mposhti Prishtinën



**PRISHTINË, 6 NËNTOR** - Golden Eagle Ylli ka vazhduar me fitore, duke mundur Sigal Prishtinën në udhëtim 68:86 (11:14, 29:17, 10:26, 18:29), në xhiron e nëntë të Prince Caffè Superligës. Kjo ishte fitorja e pestë radhazi për kampionët e Kosovës. Çereku i parë ishte kryesisht i barabartë, ku asnjëra skuadër nuk arrinte shkëputjen e madhe, ndërsa përfundoi me epërsi prej tre

pikësh nga mysafirët, 11:14. Por, periudha e dytë u takoi prishtinasve. Bardhekaltrit me një seri të suksesshme krijuan epërsi prej 31:21, ndërsa më e larta ishte 40:29, kurse skuadrat shkuan në pushim me rezultat 40:31. Por, periudhën e tretë e nisën furishëm kampionët e Kosovës, ku ngushtuar shifrat minimalisht në 42:41 dhe më pas zhvillohet një ndeshje interesante, ndërsa therandasi

e kthyen epërsinë në të mirë të tyre, kurse shifrat në semafor pas 30 minutash ishin 50:57. Therandasi edhe më shumë ngritën epërsinë në dhjetë minutat e fundit, 62:74 dhe 65:77, e më pas triumfuan me rezultat 68:86. Më i dalluari te vendasit ishte Rrezart Memedi me 18 pikë, ndërsa te mysafirët, Valon Bunjaku me 21 pikë. Të dy skuadrat kanë gjasë fitore e katër humbje.

## Derbi i takon Arsenalit, Liverpooi mposhti Tottenhamin

**Londër, 6 nëntor** - Arsenali vijon ecurinë e jashtëzakonshme në kampionat, duke marrë një fitore të madhe 1-0 në derbin ndaj Chelseat. Në "Stamford Bridge" skuadra e Artetës ishte dominuese në

lojë dhe raste. Goli i vetëm i ndeshjes u shënuar nga mbrojtësi Gabriel në minutën e 63-të duke përfituar nga një rrëmujë në zonën e Bluve të Londrës. Chelsea aktivizoi në 30 minutat e fundit edhe

Brojën, por sulmuesi shqiptar e pati shumë të vështirë që të çante mbrojtjen e Arsenalit. Granit Xhaka zhvilloi një tjetër ndeshje shumë të mirë, duke mos i kursyer as sherret në fundin e ndeshjes

me Kovaçiq. Arsenali me këtë fitore ngjitet në krye të renditjes me 34 pikë, dy më shumë se City. Ndërsa Liverpooi e ka fituar ndeshjen e dytë derbi në Angli ndaj Tottenham Hotspur me rezultat 1-2.





**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština – Assembly

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 15 (2) të Ligjit nr. 08/L-133 për Komisionerin Parlamentar për Forcën e Sigurisë shpall:

### KONKURS

#### Për zgjedhjen e Komisionerit Parlamentar për Forcën e Sigurisë

##### Funksioni i Komisionerit:

Komisioneri Parlamentar për Forcën e Sigurisë së Kosovës ka për mision fuqizimin e kontrollit parlamentar, sundimit të ligjit, dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut për personelin ushtarak në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Komisionari zgjidhet me votim të fshehtë nga Kuvendi i Kosovës, me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit të pranishëm dhe që votojnë dhe mandati i tij zgjatë pesë (5) vite pa të drejtë rizgjedhje.

##### Kriteret e përzgjedhjes:

1. Kandidatët që aplikojnë për pozitën e Komisionerit duhet ti plotësojnë kriteret si në vijim:

- 1.1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- 1.2. Të kenë diplomë universitare;
- 1.3. Të kenë, së paku, tetë (8) vite përvojë pune profesionale, nga të cilat, së paku pesë (5) vite përvojë në pozita udhëheqës;
- 1.4. Të mos kenë qenë të dënuar me vendim të formës së prerë për vepër penale;
- 1.5. Të kenë integritet të lartë moral dhe profesional;
- 1.6. Të mos jenë larguar nga puna me masë disiplinore;

2. Kandidatët që konkurrojnë për Komisioner të FSK-së i nënshtrohen procesit të verifikimit të kontrollit të sigurisë para fazës së dërgimit në kuvend për votim.

3. Kandidatët të cilët nuk pranojnë të bëhet procesi i verifikimit të kontrollit të sigurisë përjashtohen nga konkurrimi.

##### Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:

- Dëshmia për përgatitjen shkollore dhe profesionale; (diplomat nga universitetet jashtë vendit, duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë);
- Letra motivuese;
- Biografi (CV);
- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përvojën e punës (duke bashkëngjitur edhe raportin nga Trusti pensional);
- Dëshmia se nuk është i dënuar për vepër penale me vendim gjyqësor të formës së prerë.

### PROCEDURA E KONKURRIMIT

Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më 21 nëntor 2022, në orën 16:00.

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën:  
Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" pa nr., Drejtoria e Personelit, Zyra N-217).

##### Aplikacionet mund të merren në këto vende:

*Forma e shtypur:* në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" pa nr. ose

*Forma elektronike:* faqja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës [www.assembly-kosova.org](http://www.assembly-kosova.org)

Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038 211-182, 038 211-648 dhe 044 567-041.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara. Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonësë, konsiderohet i pavlefshëm.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština – Assembly

Shodno çlanu 15(2) Zakona br. 08/L-133 o parlamentarnom povereniku za bezbednosne snage Skupština Republike Kosovo, raspisuje:

### KONKURS

#### Za izbor parlamentarnog poverenika za Snage bezbednosti

##### Funkcija Poverenika:

Parlamentarni poverenik za Kosovske bezbednosne snage ima za misiju jačanje parlamentarne kontrole, vladavine prava i zaštitu ljudskih prava i sloboda vojnog osoblja u Kosovskim bezbednosnim snagama.

Poverenika bira tajnim glasanjem Skupština Kosova, većinom glasova prisutnih i koji glasaju poslanika Skupštine, a njegov mandat traje pet (5.) godina bez prava ponovnog izbora.

##### Kriterijumi za izbor:

1. Kandidati koji konkurišu za funkciju Poverenika moraju ispunjavati sledeće kriterijume:

- 1.1. Da su državljanin Republike Kosovo;
- 1.2. Da imaju fakultetsku diplomu;
- 1.3. Da imaju najmanje osam (8.) godina profesionalnog radnog iskustva, od kojih najmanje pet (5.) godina iskustva na rukovodećim pozicijama;
- 1.4. Da nisu pravosnažno osuđivani za krivično delo;
- 1.5. Da imaju visok moralni i profesionalni integritet;
- 1.6. Da nisu otpušteni sa rada uz disciplinsku meru;

2. Kandidati koji konkurišu za komesara KBS-a podležu procesu verifikacije bezbednosne provere pre nego što budu poslani u skupštinu na glasanje.

3. Kandidati koji odbiju da podlegnu procesu verifikacije bezbednosne provere isključuju se iz konkursa.

##### Uz prijavu moraju biti priložena sledeća prateća dokumenta:

- Dokaz o školskoj i stručnoj spremi; (diplome sa univerziteta iz inostranstva moraju biti nostrifikovane u Ministarstvu obrazovanja, nauke i tehnologije);
- Motivaciono pismo;
- Biografija (CV);
- Dokaz da je državljanin Republike Kosovo;
- Dokaz o radnom iskustvu (priložiti izveštaj Penzionog fonda);
- Dokaz da pravosnažnom sudskom odlukom nije osuđivan za krivično delo.

### PROCEDURA KONKURISANJA

Aplikacije se dostavljaju najkasnije do 21. novembra 2022. godine u 16:00 časova.

Aplikacije se dostavljaju lično ili putem pošte, na adresu:  
Zgrada Skupštine Republike Kosova, Priština (Ul. „Majka Tereza“ bb., Direkcija osoblja, Kancelarija N-217).

##### Aplikacije se mogu uzeti u ova mesta:

*Štampana forma:* u recepciji Zgrade Skupštine Republike Kosova, Priština, ul. "Majka Tereza" bb. ili u

*Elektronskom obliku:* internet-stranica Skupštine Republike Kosova - [www.assembly-kosova.org](http://www.assembly-kosova.org)

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana u 16:00 časova, na brojeve telefona: 038 211-182, 038 211-648 i 044 567-041.

Aplikaciju treba dostaviti uz tražena dokumenta. Korišćenje pogrešne, ili aplikacije koja nije kompletirana sa traženim podacima, kao i podaci dostavljeni sa zakašnjenjem, smatraju se nevažecim.



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553  
PRISHTINË

# Lumë's Details

## Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Xhavit Cavollari shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

- Valon Hajrullahaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Leke Dugagjini" Prizren.

- Bajram Hajrullahaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu "Leke Dugagjini" Prizren.

- Matilda Bisaku shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Lidhja e Prizrenit" Prizren.

- Vitore Tushaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Lidhja e Prizrenit" Prizren.

- Birsën Vagandji shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

- Malsore Ajgeraj shpall te pavlefshme 1 dëftesë shme "Ymer Prizreni" Prizren.

- Sedat Basha shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

- Leotrim Hoxha shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

